



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 3, datë 15/02/2021

MBI

**“NDRYSHIMIN E STRUKTURËS VJETORE TË PROCESIT MËSIMOR PËR
VITIN AKADEMIK 2020-2021, SEZONI I PROVIMEVE TË DIMRIT PËR CIKLIN E
PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË BACHELOR DHE CIKLIN E DYTË
TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve nisur nga situata e shkaktuar nga virusi SARS COVID 19, në zbatim të nenit 38, të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” pasi shqyrtoi shkresën e Ministrisë të Arsimit Rinisë dhe Sportit, “Mbi zhvillimin e disa prej provimeve të lëndëve specifike në auditor” me Nr. 749/25 Prot., datë 11.02.2021, pas diskutimeve dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Të shtyjë sezonin e provimeve të dimrit deri më datë 14.03.2021.
2. Përgjegjësitet Njësitë Bazë të përcaktojnë me detaje organizimin e provimeve të sezonit të provimeve dimrit, semestri i parë.
3. Numri i studentëve në ambientet e Fakulteteve dhe të Universitetit duhet të jetë i kufizuar dhe në duke respektuar me korrektësi maksimale protokollat anti-COVID, në fuqi.
4. Provimet e mbartura të bëhen para fillimit të provimeve semestrale dimërore duke respektuar me korrektësi maksimale protokollat anti-COVID, në fuqi.
5. Të vlerësohet e drejta e studentëve mbi vendosjen e marrjes pjesë në këtë sezon provimi. Të gjithë studentëve që nuk do të marrin pjesë në këtë sezon provimi tu krijohet mundësia e një sezoni shtesë të ndërmjetëm, në varësi të situatës së pandemisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

6. Mungesat e pjesëmarrjes në sistemin on-line, të mos penalizojnë studentët për pjesëmarrje në provimet e semestrit të parë.
7. Garantimi i kushteve për të minimizuar riskun e infektimit për studentët dhe stafin akademik si dhe ndihmës akademik, duke respektuar me korrektësi maksimale protokollet anti-COVID, në fuqi.
8. Semestri i dytë fillon më datë 15.03.2021 dhe mbaron më datë 18.06.2021.
9. Struktura vjetore e procesit mësimor për vitin akademik 2020-2021, për semestrin e dytë nuk ndryshon. Orët mësimore të mara nga provimet e sezonit të parë të zëvendësohen përgjatë semestrit të dytë sipas kalendarit të përcaktuar nga Përgjegjësit e Njësive Bazë për secilin fakultet.
10. Sektori Juridik të përgatisë sa më shpejt një rregullore të detajuar për sezonin e provimeve të semestrit të parë, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja dhe përfundimi me sukses i këtij procesi. Kjo rregullore të përgatitet në bashkëveprim dhe i konsultuar me Fakultetet e UART.
11. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca tu dërgohet për zbatim Fakulteteve në UART, Administratorit të UART, Sektorit Juridik si dhe të gjitha strukturave të tjera.
12. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)